

AULONA BEQO

SJELLJA JO E MIRË NË GJUHË

Hyrje

Studimi i sjelljes jo të mirë është po aq i rëndësishëm sa studimi i mirësjelljes, Culpeper shprehet se studimet e sjelljes jo të mirë shkojnë paralel me studimet për sjelljen e mirë të zhvilluar nga Brown dhe Levinson, por në kah të kundërt me të. I cituar nga Bousfield (2008:71) Culpeper et. Al (2003) thekson se komunikimi i pasjellshëm, në rast konflikti, ku ka agresivitet verbal dhe nuk ka bashkëpunim nga pikëpamja shoqërore është i mundur dhe ndodh gjithmonë. Studiuesit që janë marrë me këtë teori japin përkufizime të ndryshme, por bien dakord për një emërues të përbashkët duke e përcaktuar si “Sjellja jo e mirë është sjellja që rëndon imazhin e dikujt në një kontekst të dhënë”. Bousfield e zgjeron këtë përkufizim duke e dhënë kështu: “e kundërta e sjelljes së mirë, për faktin se në vend që të kërkojë të zbusë aktet kërcënuese të imazhit, përbën komunikimin e akteve verbale, konfliktuale kërcënuese të imazhit në mënyrë të qëllimshme, kjo do të quhej e plotë, nëse si folësi edhe dëgjuesi e ndjejnë kërcënimin e imazhit. Llojet e ndryshme të sjelljes jo të mirë sipas Bousfield do të ishin: “snobizmi, shkëputja nga të tjerët, mungesa e interesit, indiferentizmi, përdorimi i shenjuesve të papërshtatshëm të identitetit, fjalë tabu, sarkazma, kërcënimi apo mospërfillja etj.” Bousfield (2008:3) kundërshton idenë e Brown dhe Levinson se sjellja e mirë përbën “modelin për protokoll diplomatik dhe se “gëzon potencialin për të çarmatosur agresionin”, kjo shton autori mund të jetë e mundur pa u shfaqur agresioni, ndërsa teorinë që ai mbështet do të bëjnë të mundur që kur dikush të përfshihet në një situatë agresioni të dijë të menaxhojë situatën duke pasur njohuri mbi: 1. Llojin e sjelljes jo të mirë që mund të përdorë. 2. Menaxhimin linguistik dhe mbrojtjen që mund të sigurojë në një kontekst të dhënë. Sipas përcaktimit që Beebe 1995:145) në Bousfield (2008) bën për sjelljen jo të mirë del se ajo është instrumentale dhe i shërben “funksioneve” të caktuara. Ndër qasjet të cilat përdoren për të studiuar sjelljen e pahijshme do të përmendim; normën shoqërore apo si e perceptojnë njerëzit mirësjelljen, ndikimin e forcës së individëve, maksimat bisedore dhe menaxhimin e imazhit.

Materiale dhe metoda

Për të studiuar sjelljen jo të mirë dhe mënyrën se si realizohet në komunikim studimi I sjelljes jo të mirë në ndërveprim bëhet duke u mbështetur te puna e studiuesve që kanë ndërmarrë studime themelore në këtë teori dhe në analizën e situatave konkrete në gjuhën shqipe.

Rezultate dhe diskutime

Së pari do të mbështetemi së pari te Parimi i Bashkëveprimit të Grice-it dhe maksimat ku mbështetet ai.

1. Maksima e cilësisë

Besimi, kësaj duhet t'i binden pjesëmarrësit në dialog me çdo kusht. Nëse jo, atëherë biseda nuk është e besueshme dhe komunikimi pëson krisje.

2. Maksima e sasisë

Informimi, duhet bërë një balancë mes informacionit të ri dhe atij të njohur.

3. Maksima e të përshtaturit ndaj temës.

Ndërvepruesve ju kërkohet që t'i përmbahen temës për të cilën flitet në një kontekst të dhënë.

4. **Maksima e mënyrës-** Qartësia, të qenët i prerë, shmangia e dykuptimësisë, paqartësive. Komunikimi duhet të jetë i organizuar.

Këto **maksima** mund të **shkelen** dhe për pasojë kemi sipas Grice-it:

1. Dhunimin e një maksime.
2. Zgjedhjen për të mos e ndjekur një maksimë.
3. Përplasjen e maksimave, kur nuk përmbushet njëra, rrezikohet të mos përmbushet edhe tjetra.
4. Shpërfilljen e qëllimshme e maksimave. Kjo bëhet në mënyrë të dukshme që të vihet re nga ndërvepruesi.
5. Pezullimin i një maksime, nisur nga gjykimi se jo të gjitha duhen përmbushur.
6. Shkeljen e një maksime pa motiv apo nga mungesa e vëmendjes ndaj saj.

Aktet e kërcënimit të imazhit gjatë studimit të sjelljes jo të mirë:

Çfarë janë aktet e kërcënimit të imazhit? "Akte të cilat nga natyra bien ndesh me dëshirën për imazh të të adresuarit apo folësit". (Brown & Levinson, 1987, p. 65).

Po imazhi në çfarë konsiston? Sipas Terkouraffi-t në Bousfield, D., & Locher, (2008:48) Brown & Levinson, 1987, p. 61) në kemi këto përkufizime për imazhin/fytyrën:

Fytyra/Imazhi: "imazhi publik që çdo anëtar i shoqërisë pretendon për veten"

Fytyra pozitive/Imazhi pozitiv: "Dëshira e çdokujt që dëshirat e tij t'i pëlqejnë, të paktën disave.

Fytyra negative/Imazhi negativ: "Dëshira e çdo të rrituri të aftë që të mos e pengojnë në veprimet e tij"

Gofman (1967) citohet nga Dawn Elisabeth Archer në Bousfield dhe Locher (2008:183) në përkufizimin që i bën cenimit të imazhit, ai dallon tri lloje cenimi të imazhit: të qëllimshëm, aksidental dhe të paqëllimshëm.

Super strategjitë e Culpeper-it reflektojnë super strategjitë e Brown dhe Levinson të sjelljes së mirë. Me anë të tyre autori përpiket që të shpjegojë fenomenin e sjelljes jo-të mirë.

Culpeper (1996) përcakton edhe strategjitë për sjelljen jo të mirë pozitive dhe negative:

Strategjitë e sjelljes jo të mirë pozitive:

Shpërfill dikë, nuk vëren praninë e tij. Përrjashtim nga një veprim.

Shkëputje sociale me dikë, shmangie e dikujt.

Sjellja jo e mirë në gjuhë

Mosinteresimi për dikë.

Përdorimi i shenjësve të papërshtatshëm të identitetit. (përdorimi i mbiemrit dhe titullit, apo përdorimi i shkurtimit të emrave apo nofkave kur një afërsi e tillë nuk është e lejueshme.)

Përdorimi i gjuhës me nënkuptime apo qëllime të errëta (Përdorimi i zhargonit/dialektit që njihet nga i gjithë grupi, por jo ndërvepruesi drejtpërdrejt).

Kërkim të mosdakordësisë. Kur zgjidhet një çështje delikate, e bën tjetrin të ndihet keq, mosshmangia e heshtjes dhe bërja e bisedave të vogla.

Përdorimi i fjalëve tabu, betimeve apo një gjuhës profane.

Sharjet, apo përdorimi i përcaktimeve qesharake/tallëse.

Strategjitë e sjelljes jo të mirë negative.

Frikësimi – instalimi i frikës përmes veprimeve shkatërruese

Përbuzja, tallja – zvogëlimi i tjetrit përdorimi i shprehjeve zvogëluese, mosmarrja me seriozitet.

Zaptimi i hapësirave të tjetrit, në mënyrë konkrete (pozicionimi më afër se ç'ju lejohet) apo jo konkrete (përdorimi i shprehjeve që tregojnë afërsi).

Asocimi me tjetrin me një aspekt negativ- personalizimi, përdorimi i përemrave “unë” dhe “ti”.

Bërja e ditur e të qenit borxhli ndaj tjetrit.

Shembuj të sjellë nga salla e gjyqit për secilën strategji:

1. Sjellje jo e mirë e qartë, kërkesë apo urdhër pa asnjë veprim rregullues apo zbutës.

- Dakord, lexo përgjigjen tjetër.

2. Më lejo t'ju pyes, Ben.

Dëshmitari: Unë e sqarova këtë...

Avokati: Faleminderit, zotëri.

3. Përdorimi i shenjësve të papërshtatshëm të identitetit.

4. Shpërfillja, avokati e ndërpret dëshmitarin

Strategji të sjelljes jo të mirë negative

Zvogëlimi i figurës së dikujt, tallja me dikë.

1. Në ato dy minuta që e pe librin që është qendra e debatit, në atë shikim dy-minutësh, a pe diçka që bie ndesh me ty?

Shkëputja nga dikush përmes strategjisë së sjelljes jo të mirë negative.

2. Duhet të më kishe treguar për atë gjë, apo jo, për të qenë i sinqertë?

Përveç shprehjeve verbale Culpeper thekson edhe rëndësinë që kanë shenjat jo-verbale në aktet e sjelljes jo të mirë. (Culpeper 1995: 10)

Forca dhe sjellja jo e mirë, marrëdhënia që ekziston mes tyre

Sipas Bousfield në Bousfield and Locher (2008:139) “Sjellja jo e mirë instrumentale, e cila synon të ndikojë te ndërvepruesi në një kontekst të caktuar në mënyra gjuhësore, por jo vetëm, lidhet në mënyrë direkte me konceptin për forcën.” Autori citon Watts (1991:60) për modelin e forcës për të... dhe modelin e forcës mbi:

“Një individ A ka forcë nëse ai/ajo ka liri veprimi për të arritur synimet që i ka vendosur vetes, edhe nëse kjo përfshin potencialin për të detyruar të tjerët që të kryejnë veprime në shërbim të A –së.

Për sa i përket forcës mbi, Watt (1991:62) ibid e përkufizon kështu:

“A ushtron forcë mbi B, kur A ndikon te B në një mënyrë të ndryshme nga interesat fillestare të perceptuara nga B, pa marrë parasysh nëse B më vonë do të pranojë veprimet e A-së si të dëshirueshme.

Një model tri-planësh i forcës i cituar nga Bousfield në Bousfield and Locher (2008:139) është ai i Wartenbergut dhe që përkon me 1. forcë, 2. frikësim 3. ndikim. E para lidhet me përdorimin e forcës për të kufizuar hapësirën e veprimit të dikujt, në rastin e dytë kemi përdorim të forcës së kombinuar me kërcënim dhe së treti përdorimi i ‘mjeteve të dyshimta moralisht’.

Në cilat forma shfaqet forca? Për të treguar format dhe shfaqjet e ndryshme të forcës mund të marrim parasysh modelin e ofruar nga Locher (2004: 39-40)

1. Forca (shpesh) shprehet përmes gjuhës.
2. Forca nuk mundet që të shpjegohet pa e kontekstualizuar atë.
3. Forca është relative, dinamike dhe e kundërshtueshme.
4. Lidhja e ndërsjellë mes gjuhës dhe shoqërisë mund të shihet në shfaqjen e forcës.
5. Liria e veprimit nevojitet për të ushtruar forcë.
6. Kufizimi i hapësirës së veprimit të ndërvepruesit shpesh çon në ushtrimin e forcës.
7. Ushtrimi i forcës përfshin një konflikt ekzistues, por jo të dukshëm, apo një përplasje interesash, të cilat mund të errësohen nga ideologjitë shoqërore.

Marrëdhënia ndërvepruese dhe Norma shoqërore

“Nëse ndërvepruesit e perceptojnë një mesazh si të sjellshëm ose jo, kjo varet nga gjykimet gjatë ndërveprimit.” (Locher dhe Bousfield (2008:78) Gjykimet që krijojnë ndërvepruesit bazohen te përvoja të mëparshme që mund të kenë pasur, autorët huazojnë një term të përdorur më parë nga Tannen 1993 dhe Escandell-Vidal (1996), i cili është “kornizë” dhe lidhet me konceptimet konjitive të përvojave të përmendura më sipër.

Normat të cilave individët ju referohen në shoqëri janë në ndryshim të vazhdueshëm, po kështu ndryshojnë edhe gjykimet që krijohen gjatë ndërveprimit, e në të njëjtën mënyrë ndryshon edhe koncepti mbi atë që quhet sjellje jo e mirë. Watts 2003; Locher dhe Watts 2005 të cituar ibid. e quajnë këtë fleksibilitet natyrën “discursive” të sjelljes së mirë dhe asaj jo të mirë. Nuk ka prerje me thikë mbi atë që është sjellje gjuhësore e mirë ose jo. ibid.

Watts dhe Locher sjellin një tabelë ku paraqiten aspekte të gjykimeve që ndërvepruesit bëjnë në një marrëdhënie ndërvepruese e cila mund të cilësohet si “e sjellshme”

Aspekte të spektrit të marrëdhënies ndërvepruese, e sjellë me leksemën “mirësjellje” në një kontekst të dhënë Y.

	Leksema (niveli i parë)	Dy nga domenet konjitive përkundrejt të cilave	
--	-------------------------	--	--

Sjellja jo e mirë në gjuhë

		leksema profilizohet.	
Gjykimi a	e pasjellshme	E papërshtatshme/jo-politike	+ e shenjuar negativisht
Gjykimi b	Jo e sjellshme	E përshtatshme/politike	+ e pashenjuar
Gjykimi c	E sjellshme	E përshtatshme/politike	+ e shenjuar pozitivisht
Gjykimi d	Tepër e sjellshme	E papërshtatshme/jo-politike	+ e shenjuar negativisht

Shënim i autorëve për Gjykimin b, ky gjykim nuk ka gjasa të shprehet.

Shënim “sjellje politike përkufizohet si sjellje e duhur ndaj kushtëzimeve të një ndërveprimi në proces”¹

Si arrihet sjellja jo e mirë përmes shprehjeve gjuhësore?

Jamet (2013:8) citon ofron një listë të adoptuar nga Culpeper për të treguar se si mund të realizohet sjellja jo e mirë përmes shprehjeve gjuhësore.

1. Përmes thirrurëve/cilësimeve negative të identitetit:
Budalla, idiot, trashalug, etj.
2. Vlerësime individuale negative
Je çmendur,
Nuk bën një gjë si duhet,
3. Shprehjeve që ndjekin dikë.
Ik, zhduku,
4. Shprehjeve që synojnë të bëjnë dikë të heshtë:
Pusho, mos fol, qepe.
5. Kërcënimeve:
Do të ta bëj kurrizin më të butë se barku, do të të zhdëp në dru, etj. Jamet (2013:8)

Konkretizime të sjelljes jo të mirë në shqip.

Gjatë punës së tyre dy policë rrugorë, kanë ndaluar një mjet të drejtuar nga një femër, e cila ka dalë nga makina dhe i ka rënë leja e drejtimit, duke menduar se policët ia kanë mbajtur atë nis një dialog i cili përfundon me konflikt verbal dhe fizik mes drejtueses së mjetit dhe efektivëve të policisë në detyrë.

Model sjelljeje konfliktuale mes dy policëve dhe një drejtuese mjeti:

S1: Ik moj k...!

S2: (pëstyn) Kush është k...? Do thërras policinë tani, në sekondë! (bërtet)

(nuk dëgjohen fjalët e policëve.)

S2. A qelbësirë m... Kush është k...? A të.....!

(Policë godet me shuplakë.)

(një qytetar ndërhyr për t'i ndarë)

(vazhdon debati, por nuk dëgjohet më tej)²

¹ Impoliteness: Using Language to Cause Offence by Jonathan Culpeper 2011.

Në këtë dialog vihen re ushtrimi i forcës, dhunës fizike dhe verbale. Maksimat e Grice janë shkelur, ajo e mënyrës, drejtuesja e mjetit përdor zërin e lartë, ajo e cilësisë, gjuha që përdor drejtuesja, por edhe punonjësit e policisë është dukshëm sjellje jo e mirë, drejtuesja e mjetit shkel edhe maksimën e sasisë në kohën kur e përsërit dy herë pyetjen: “Kush është k...? Kërcënimi i imazhit bëhet përmes strategjisë së të thënit të gjërave hapur, përmes ofendimeve dhe përdorimit të fjalëve tabu. Si efekt perlokutor të këtij ndërveprimi kemi aktin e pështyrjes dhe konfliktin fizik mes policëve dhe drejtueses së mjetit.

Në një seancë në Komisionin e ekonomisë:

S1: Çfarë jeni ju?

S2: Pastruese.

S1: Atëherë dilni nga salla, dakord!

S2: Kam ardhur në komision.

S1: Atë e vendos unë, ju lutem largohuni nga karrigia.

S2: Nuk largohem, nuk largohem, jam në komision.

S1: Urdhëroj unë këtu.

S2: Më kanë caktuar për të ardhur për të mbrojtur diçka.

S1: E përcaktoj unë, kështu që tërhiq mbrapa!

S2: Nuk mund të largohem.

S1: Tërhiq, se do ndërpres komisionin, po të them.

S2: Ndërprite!

S1: Nuk thërras pastruese unë këtu.

S2: Ndërprite!

S3: (shpjegon pozitën e folëses dhe mundohet të zbusë situatën duke e shpjeguar atë në kuadrin e humorit.)

Vazhdon...

Parimi i bashkëpunimit duket se është shkelur këtu, maksima e mënyrës, ka tension mes ndërvepruesve, maksima e sasisë, kemi përsëritje, ***nuk largohem, nuk largohem, ndërprite, ndërprite, tërhiq, tërhiq***. Në këtë rast vëmë re një mungesë dëshire për të vazhduar diskutimin, kemi tregues të forcës, ku S1 është kreu i komisionit dhe S2 një nëpunëse që thirret për të dhënë, vihet re përdorimi i përemrit “unë”.

Kemi përdorim të shprehjes “po të them” e cila tregon afërsi mes ndërvepruesve, në vend të “po ju them” shprehjes që tregon distancë dhe formë mirësjelljeje). S2 përdor strategjinë e dëmtimit të imazhit vetjak duke përdorur termin “pastruese” në mënyrë ironike, duke nënkuptuar se nuk është e udhës të kërkohet një prezantim, kur gjërat duhet të zhvillohen sipas një procedure, ku është e përcaktuar në axhendë se kush merr pjesë në këtë mbledhje. Duke qenë se dy ndërvepruesit nuk arrijnë të vendosin komunikimin e rregullt ndërhyr S3, cili

² Fjalitë nuk janë dhënë të plota për shkak se gjuha e përdorur, personalisht më duket shumë e rëndë.

Sjellja jo e mirë në gjuhë

përpiqet që të zbusë situatën duke shpjeguar se përgjigja e S1 ishte në kuadrin e humorit.

Përfundime

Teoria e sjelljes jo të mirë është një fushë që po i kushtohet një vëmendje në rritje për shkak të informacionit që mund të na ofrojë për ndërveprimin njerëzor, lidhjet mes ushtrimit të forcës mes ndërvepruesve. Duke qenë se shpesh gjendemi në situata ku jo gjithmonë përdorimi i sjelljes së mirë është zgjidhja, duhet të dimë të se si t'i interpretojmë dhe t'i zgjidhim këto situata.

Siç vihet re nga situatat e analizuara, sjellja jo e mirë është e pranishme, ajo shfaqet në mënyra të ndryshme, në varësi të situatave. Njohja e kontekstit, analiza e parimeve të bashkëpunimit, normat që shoqëria ndjek dhe forca që ndërvepruesit ushtrojnë përmes gjuhës ndaj njëri-tjetrit janë bazat ku mbështetemi për të analizuar sjelljen jo të mirë në ndërveprim.

Me situatat e përdorura është bërë përpjekje për të ilustruar sjelljen jo të mirë, kryesisht atë me natyrë "instrumentale", por mbeten akoma shumë situata të tjera që mund të studiohen në punime tjera.

BIBLIOGRAFI

- D. Bousfield (2008). *Impoliteness in interaction*. Amsterdam: John Benjamins Pub.
- D. Bousfield & M. A. Locher (2008). *Impoliteness in language: Studies on its interplay with power in theory and practice*. Berlin: Mouton de Gruyter.
- D. Jamet, & M. Jobert (2013). *Aspects of linguistic impoliteness*.
- J. Culpeper (2011), *Impoliteness: Using Language to Cause Offence*.
- M. A. Locher (2004). *Power and politeness in action: Disagreements in oral communication*. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Transkriptet e dy dialogjeve të përdorura si modele janë marrë nga You Tube.
<https://www.youtube.com/watch?v=Onr5V8-IIQM>
<https://www.youtube.com/watch?v=Wrcy5JID1u0>

